

VENDIM
Nr. 756, datë 16.9.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 503, DATË 1.8.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET
FUNKSIONALE TË QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 503, datë 1.8.2007, të Këshillit të Ministrave, tarifa e shërbimit “Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt” ndryshohet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela nr. 1

	Shërbimi	Tarifa në lekë
11	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 1 fletë deri në 20 fletë	100
11/1	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, me 21 fletë deri në 100 fletë	500
11/2	Lëshimi i ekstrakteve të historikut të veprimeve të kryera nga një subjekt, mbi 100 fletë.	1 000